# AKT-THEMELIMI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "VASA" ME SELI NE FIER.

Ne Fier, sot me daten 30.12.1995, neve te nenshkruarit
1.- Aleksander Vasili, i biri i Jorgjit dhe i Garufes, lindur dhe banues ne qytetin e Fierit, lagje Liri Gero, me datlindje 1964, afarist.
2.- Janaq Samara, i biri i Dhimitrit dhe i Aleksandres, lindur dhe banues ne Fier, lagje 11 Janari, me datlindje 1962, afarist.

Me vullnetin tone te lire dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, duke pasur parasysh edhe kerkesat e ligjit Nr.7638 date 19. 11.1992 mbi shoqerite tregetare dhe te ligjit Nr. 7512 date 10.8.1991 mbi nismen e lire private sidhe objektin e veprimtarise private qe do te ushtrojme e kapitalin themeltar qe kemi,

## V E N D O S E M

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "VASA" me seli ne Qytetin e Fierit, shkurt sh.p.k. "VASA" Fier.

Objekti i veprimtarise private te kesaj shoqerie do te jete :

Import-Eksport mallnash industriale te llojeve te ndryshme, pjese nderimi per makineri e paisje, lende te para te industris kimike dhe tregetimi i tyre me shumice e me pakice.

Ne prespektive shoqeria do te shtoje veprimtarine e vet private edhe ne drejtime te tjera dhe sidomos ne punime e sherbime elektrike e mekanike, ne perputhje me licensat personale qe kane ne keto fusha ortaket e saj.

Shoqeria do te kete pasurine e vet te pavarur dhe pergjegjesi pasurore per detyrimet e saj, duke dale ne qarkullimin civil si subjekt i pavarur privat.

Shoqeria do te ushtroj veprimtarine e vet ne Rethin e Fierit, ku ka edhe selinë e saj, por ajo per interesat e veta mund te hapi agjensi e filiale edhe ne Rethet e Sarandes, Tiranes, Vlores e Rethe te tjera te vendit.

Jetegjatesia e shoqerise mbi 10 vjet.

Kapitali themeltar ne mjete xhiro 100.000 leke, vene nga neve themeluesit e saj ne menyre te barabarte.

Kapitali tjeter qe do te futet ne kete shoqeri nga ortaket e vecante pas likujdimit te vleftes te caktuar personit fillestar, behet prone e perbashket e shoqeerise , kurse kapitali tjeter qe do te futet direkt nga fondet e shoqerise, eshte ne pronesi te saj dhe u perket ortakeve ne menyre te barabarte.

Veprimtarine e vet private shoqeria do ta ushtroj mbeshtetur ne kerkesat e ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 mbi shoqerite tregetare si dhe ne perputhje me dispoziat e tjera ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise, ne kushtet e kooperimit, bashkepunimit e konkurences se lire me subjekte te tjera private vendese e te huaja.

Fitimi neto do te ndahet midis dy ortakeve ne menyre te barabarte qe jane themelues te kesaj shoqerie, mbasi ajo eshte e ardhur eskluzive e jona.

Themeluesit e kesaj shoqerie do te perballojne vete humbjet eventual deri ne kufirin e vleftes se kontributit ne kapitalin themeltar.

Drejtimi i shoqerise, funksionimi dhe veprimtaria e saj private do te behet ne perputhje me statutin e kesaj shoqerie, i cili eshte miratuar sot prej nesh.

Si administrator te shoqerise emerojme zotin Aleksander Vasili.

Shoqeria do te kerkoj te regjistrohet si person juridik privat ne Gjykaten e Rrethit Tirane, ne perputhje me ligjin nr. 7667 date 18.1.1993 per regjistrimin tregetar.

T H E M E L U E S I T

Aleksander Vasili — Janaq Samara

Republika e Shqiperise
Zyra e Noteris Fier
Nr. 211 Regj.

V E R T E T I M

Vertetohet se ky akt themelimi eshte neneshkruar personalishte nga z. terijte Aleksander Vasili dhe Janaq Samara me vullnetin e tyre te lire.

Noteri Minella Milo

PULLE TAKSE

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " VASA" ME SELI NE FIER

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 " Mbi shoqerite tregetare" dhe dispozitat e tjera ligjore qe veprojne ne Republiken e Shqiperise, krijohet dhe do te funksionoje shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " VASA " me seli ne qytetin e Fierit, shkurt sh.p.k. " VAS A", ne perputhje me normat e ketij statuti dhe ligjet e shtetit shqiptar.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " VASA"me qender ne Fier, eshte person juridik privat. Si person juridik privat ajo ka pasurine e saj te pavarurx mban pergjegjesi te pavarur per detyrimet e veta dhe mer pjese ne qarkullimin civil ne emer te ve[t]

#### neni 2

Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

#### neni 3

Shoqeria me kete statut, ne perputhje me aktin e themelimit te saj dhe legjislacionin e Republikes se Shqiperise, rregullon poziten juridike te veprimtarise se vet, objektin dhe organizimin e punes dhe ceshtje te tjera qe kane rendesi per aktivitetin e saj.

#### neni 4

Shoqeria do te ushtroj veprimtarine e vet ne Rethin e Fierit, ku ka edhe seline e saj, por ajo per interesat e veta mund te hapi agjensi e filiale edhe ne R ethet e Sarandes, Tiranes, Vlores e Rethe te tjera te vendit.

#### neni 5

Shoqeria " VASA " eshte krijuar me mjetet e veta

[stamp] financjare, te vena nga themeluesit e saj.

neni 6

Objekti i shoqerise me pergjegjeis te kufizuar " VASA " do te jete :

Import-Ekspott mallnash industriale te llojeve te ndryshme, pjese nderimi per makineri e paisje, lende te para te industris kimike dhe tregetimi i tyre me shumice e me pakice.

Neni 7

Ne prespektive shoqeria do te shtoje veprimtarine e vet private edhe ne drejtime te tjera dhe sidomos ne punime e sherbime elektrike e mekanike, ne perputhje me licencat personale qe kane ne keto fusha ortaket e saj.

neni 8

Mallnat e shoqerise mund te tregetohet brenda dhe jashte vendit ose te importohen sipas mareveshjeve perkatese me shoqeri e firma te vendit ose te huaja.

KAPITALI I SHOQERISE

neni 9

Kapitali themeltar i shoqerine ne mjete xhiro 100.000 lek, vene nga themeluesit e saj ne menyre te barabarte.

neni 10

Kapitali tjeter qe do te futet ne kete shoqeri nga ortaket e vecante pas likujdimit te vleftes te caktuar personit fillestar, behet prone e perbashket e shoqerise, kurse kapitali tjeter qe do te futet direkt nga fondet e perbashketa te shoqerise, eshte ne pronesi te saj dhe u perket Ortakeve ne menyre te barabarte.

neni 11

Kapitali eshte i transferushem me trashegim ne rast vdekje

dhe me akt noterial midis te gjalleve ne favor te trashegimtareve te tjere, ne perputhje me dispozitat ligjore te kodit civil.

neni 12

Shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltar sidhe ate te mjeteve kryesore te xhiros, shoqeria do ta beje ne perputhje me interesat e saj ekonomike per shtimin ose pakesimin e veprimtarise se vet trgetuese.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

neni 13

Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane ;asambles e bashkepronareve, administratori dhe komisioni i kontroll- revizionit

ASAMLEA E SHOQERISE

neni 14

Asamblea e shoqerise eshte organi vendimor. Ajo perbehet nga bashkepronaret e kesaj shoqerise.

Neni 15

Asamblea e shoqerise mer vendime per keto ceshtje kryesore:

1.- Miraton statutin e shoqerise dhe amendamentet qe mund ti behen keti statuti.

2.- Miraton llogarite vjetore te shoqerise dhe raportin vjetor te llogarise.

3.-Vendos per ritjen apo zvogelimin e kapitalit baze.

4.- Emeron administratorin e shoqerise dhe komisionin e kontroll- revizionit.

5.- Vendos per shperndarjen e fitimit neto te shoqerise.

6.- Per marjen dhe perdorimin e kredive te ndryshme dhe per perdorimin e investimeve.

7.- Vendos per te gjitha drejtimet kryesore te veprimtarise te shoqerise, si per numerin e fuqis puntore, pagen e tyre e tjera.

NOTER FIER



neni 16

Vendimet ne asamble meren me komsesus.

DETYRAT DHE KOPETENCAT E ADMINISTRATORIT

neni 17

Drejton problemet qe kane te bejne me blerjen dhe shitjen e mallnave e materialeve dhe gjithe veprimtarine e shoqerise qe kane te bejne me keto probleme.

neni 18

Ndjek maredhenijet kontraktore me te tretet, kontratat e punesimit me punonjesit.

neni 19

Perfaqeson shoqerine para organeve gjyqesore, arbitrazhit dhe organeve administrative sidhe para personave te trete.

neni 20

Mer persiper dhe pergjigjet per zbatimin e kerkesave te ligjeve per standartet e cilesine, per hygjen e pastertine, per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune, per shlyerjen e detyrimeve tatimore, per maredhenijet me banken e tjera.

neni 21

Krijon rezerven e nevojshme baraz me 1 / 10 e kapitalit nga fitimi i rezervuar gjete vitit financjar.

KOMISIIONI I KONTROLL REVIZIONIT

neni 22

Komisioni i kontroll- revizionit caktohet nga asamblea sa here ta cmoje ajo te nevojshem. Ky komision kryen detyrat e kontrollit e te revizionit ne te gjithe aktivitetin ekonomiko financjar te shoqerise,.

neni 23

Rezultatet e veta komisioni i kontroll - revizionit ja paraqet asamblese me nje relacion te vecante dhe me te gjitha te dhenat e nevojshme.

neni 24

Komisioni i kontroll - revizionit perbehet nga specialis te fushes perkatese qe nuk jane punonjes te shoqerise.

MAREDHENIJET FINANCJARE

neni 25

Administratori i shoqerise ndjek vete ose nepermjet nje personi te ngarkuar prej tij zbatimin e regullave qe kane te bejne me kontabilitetin dhe bankes perkatese (shteterore ose private).

neni 26

Mjetet monetare te shoqerise rugen ne banke, ne numerin e llogaris te caktuar prej saj. Mjetet monetare ne kete llogari jane mjete te shoqerise dhe perdoren vetem me urdher te leshuar prej administratorit per blerjen e lendeve te para, mallnave, paisjeve, pagat e punonjesve dhe shpenzime te tjera.

neni 27

Mjetet monetare qe ndodhen ne banke mund te levizen edhe nga vete banka, ne rastet e parashikuara ne ligj. Te tilla raste jane :

- Kur vihet ne ekzekutim vendimi i organit te kontrollit financjar per shkeljet e bera gjate ushtrimit te veprimtaris private.

-Kur vihet ne ekzekutim nje vendim i formes se prere te Gjykates ose nje titull tjeter ekzekutiv.

neni 28

Banka, shtimin ose pakesimin e mjeteve monetare te

shoqerise, do ta beje me urdher xhirim ose ceqe te neneshkruara dhe te pranuara nga administratori.

neni 29

Shoqeria detyrohet te derdhi ne interes te shtetit sipas ligjes, keto detyrime:

- Detyrime per taksa e tatime.
- Detyrime per kontributet e sigurimeve shoqerore.
- Detyrime per sigurimin e pasurise nga zjarri dhe fatkeqesi te tjera te natyres.

neni 30

Shoqeria detyrohet qe veprimtarine e saj ta pasqyroj dhe dokumentoje sipas ligjit mbi kontabilitetin.

neni 31

Fitimi neto eshte pasuri e shoqerise. Po ashtu edhe humbjet mbeten per llogari te saj.

neni 32

Shoqeria ka te drejte te caktoje vete cmimet e mallnave, por duhet te kete parasysh edhe kerkese oferten dhe ligjet ose vendimet qe disiplinojne cmimet.

neni 33

E shte e drejta e administratorit te shoqerise qe te caktoje nje person te vecante per mbajtjen e llogarise dhe zbatimin e ligjes mbi kontabilitetin.

MAREDHENIJET KONTRAKTORE

neni 34

Duke qene person juridik privat, ne veprimtarine e vet ekonomike, shoqeria do te fitoj te drejta dhe do te mare persiper detyrime dhe pergjegjesi, per te cilat pergjigjet me mjetet e veta financjare, brenda kufijve qe percaktojne aktet mbi maredhenijet kontrak...

neni 35

Ne kontratat qe do te lidhen do te parashikohen me saktesi llojet e mallnave qe do te blihen ose do te shiten, cilesia e tyre cmimet, detyrimet e paleve, gjabat dhe pagesat e mallnave te pa paguara dhe fitimi i munguar.

neni 36

Kontratat do te lidheh ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, gje qe do te kerkohet edhe nga pala tjeter.

neni 37

Shoqeria nuk ka kufizime per lidhje kontratash me persona fizike e juridike brenda dhe jashte vendit.

neni 38

Shoqeria mund te beje edhe kontrata dhurimi ne favor te personave ose institucioneve te ndryshme.

MAREDHENIET E PUNESIMIT

neni 39

Marja ne pune e punonjesve behet nga administratori, sipas nevojave te punes, duke pasur parasysh aftesite fizike, arsimore dhe pregatitjen profesionale te tyre.

neni 40

Marja ne pune dhe fillimi nga puna do te behet me regjistrimin e personit te punesiar ne regjistrin perkates te shoqerise dhe pas neneshkrimit te kontrates te punes midis dy paleve.

neni 41

Shoqeria eshte e detyruar te respektoje ligjin mbi maredhenijet e punes dhe ate mbi sigurimet shoqerore.

neni 42

Kontrata e punes duhet te permbaje kushtet e punes, shperblimin e punes, kushtet hygjenosanitare, regullat e zgjidhjes se

kontrates se punes e te mosmarveshjeve sidhe pergjegjesine materiale te punonjesve.

SHPERBERJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

neni 43

Shoqeria mund te shperbehet ne formen e likujdimit dhe te riorganizimit. Formen e riorganizimit e vendos vete asamblea e shoqerise.

Kur shoqeria likujdohet asamblea cakton komisionin e likijdimit me ekspert financjare te jashtem dhe shoqeria pushon veprimtarine e vet.

Komisioni i likujdimit i paraqet asamblese raportin e likujdimit ne lidhje me detyrimet e shoqerise ndaj paleve te tjera.

DISPOZITA TE FUNDIT

neni 44

Per gjithcka qe nuk eshte parashikuar ne kete statut, vlej ne dispozitat ligjore qe regullojne problemet qe eventualishte mund te dalin dhe qe veprojne ne Republiken e Shqiperise.

neni 45

Gjykata kompetente per shqyrtimin e mosmareveshjeve eshte gjykata ku ka qendren e vet shoqeria.

neni 46

S hoqeria ka vulen e saj ne forme te rumbullakte me permbajtje: sh.p.k. " VASA" Fier, import-eksport.

Ky statut eshte miratuar nga bashkepronaret themelues ne Fier date 30.12.1995.

Administratori

Aleksander Vasili

Republika e Shqiperise
Zyra e Noteris Fier
Nr. 211

V E R T E T I M

Vertetohet se ky statut eshte neneshkruar personalishte

nga zoti